



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.51

3 maj

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 262 datë 8.4.2010	Për ratifikimin e “Marrëveshjes, me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Holandës për privilegjet dhe imunitetet e oficerit ndërlidhës”	1851
Ligj nr.10 263 datë 8.4.2010	Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara	1854
Ligj nr. 10 264 datë 8.4.2010	Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar	1860
Ligj nr.10 265 datë 15.4.2010	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Letonisë për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve”	1861
Ligj nr.10 266 datë 15.4.2010	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8897, datë 16.5.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”	1865

LIGJ
Nr.10 262, datë 8.4.2010

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES, ME SHKËMBIM NOTASH, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË HOLANDËS PËR PRIVILEGJET
DHE IMUNITETET E OFICERIT NDËRLIDHËS”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja, me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Holandës për privilegjet dhe imunitetet e oficerit ndërlidhës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6520, datë 28.4.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Draft-Note në përgjigje

Ambasada e Republikës së Shqipërisë i paraqet komplimentet e saj Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës dhe ka nderin të konfirmojë marrjen e notës nr.542/09, datë 30 korrik 2009, në lidhje me propozimin për të përfunduar një marrëveshje ndërmjet Mbretërisë së Holandës dhe Republikës së Shqipërisë mbi privilegjet dhe imunitetet e oficerit ndërlidhës të Shqipërisë në Europol, e cila lexon sa vijon:

Teksti i Notës Hyrëse

Ambasada ka nderin të informojë Ministrinë e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës se bie dakord me përmbajtjen e Notës së sipërcituar, dhe se Nota e Ministrisë dhe kjo Notë, duke shprehur miratimin e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, do të përbëjë një marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Holandës, e cila do të zbatohet përkohësisht nga dita në të cilën kjo notë firmuese është marrë nga Ministria, dhe e cila do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit (të dytë) pas datës në të cilën Republika e Shqipërisë dhe Mbretëria e Holandës informojnë njëra-tjetrën se formalitetet e kërkuara për hyrjen në fuqi janë kryer.

Ambasada e Republikës së Shqipërisë përfiton edhe një herë nga rasti për t'i përsëritur Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës sigurimet e konsideratës së saj më të lartë.

Shtojca

1. Përkufizime

Në këtë Marrëveshje:

a) “Oficer ndërlidhës” nënkupton çdo oficer të vendosur në Europol në përputhje me nenin 12 të Marrëveshjes;

b) "Qeveri" nënkupton Qeverinë e Mbretërisë së Holandës;
c) "Autoritetet e vendit pritës" nënkupton një shtet të tillë, bashki ose autoritete të tjera të Mbretërisë së Holandës siç mund të jetë e përshtatshme në kontekst dhe në përputhje me ligjet dhe zakonet e aplikueshme në Mbretërinë e Holandës;

d) "Shtet dërgues" nënkupton Republikën e Shqipërisë;

e) "Arkivat e oficerit ndërlidhës" nënkupton të gjitha regjistrimet, korrespondencat, dokumentet, dorëshkrimet, të dhënat kompjuterike dhe të mjeteve të komunikimit, fotografitë, filmat, videot dhe regjistrimet zanore që i përkasin ose të mbajtura nga oficeri ndërlidhës, ose ndonjë tjetër material i ngjashëm, i cili në opinionin unanimitet të shtetit dërgues dhe qeverisë formon pjesë të arkivave të oficerit ndërlidhës.

2. Privilegjet dhe imunitetet

1. Sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, oficerët ndërlidhës dhe anëtarët e familjes së tij të cilët përbëjnë pjesë të banorëve të shtëpisë së tij dhe të cilët as nuk kanë kombësinë holandeze dhe as nuk janë rezidentë të përhershëm në Mbretërinë e Holandës, do të gëzojnë në dhe krahas Mbretërisë së Holandës të njëjtat privilegje dhe imunitete siç u janë akorduar anëtarëve të stafit diplomatik nga Konventa e Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike datë 18 prill 1961.

2. Imuniteti i dhënë personave të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni nuk do të shtrijë efektet për çdo:

i) veprim civil nga një palë e tretë për dëmtimet, duke përfshirë dëmtimet personale ose vdekjen, që rrjedhin nga një aksident rrugor shkaktuar nga ndonjë person i tillë; ose

ii) juridiksion penal dhe civil mbi veprimet e kryera jashtë rrjedhës së detyrave të tyre zyrtare.

3. Detyrimet e shtetit dërgues dhe personelit të tyre që zbatohen sipas Konventës së Vjenës ndaj anëtarëve të stafit diplomatik, do të zbatohen ndaj personave të referuar në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Hyrja, qëndrimi dhe nisja

1. Qeveria do të lehtësojë, nëse është e nevojshme, hyrjen, qëndrimin dhe nisjen e oficerit ndërlidhës dhe anëtarëve të familjes së tij që përbëjnë pjesë të banorëve të familjes.

2. Ky nen nuk do të ndalojë kërkimin e provave të arsyeshme për të vendosur që personat që kërkojnë trajtimin e parashikuar nga ky nen bëjnë pjesë në kategorinë e përshkruar në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Vizat që mund të kërkohen nga personat e referuar në këtë nen do të jepen pa shpenzime dhe sa më shpejt që të jetë e mundur.

4. Punësimi

Anëtarët e familjes që përbëjnë pjesë të banorëve të shtëpisë së oficerit ndërlidhës, që nuk kanë shtetësinë e një shteti të Bashkimit Europian, do të përjashtohen nga detyrimi për të fituar leje pune për periudhën e vazhdimit të detyrës së oficerit ndërlidhës.

5. Paprekshmëria e arkivave

Arkivat e oficerit ndërlidhës kudo që janë vendosur dhe nga kushdo që i mban janë të paprekshme.

6. Mbrojtja personale

Autoritetet e shtetit pritës, nëse kërkohet nga shteti dërgues, do të ndërmarrin të gjitha hapat e arsyeshme, në përputhje me ligjet e tyre kombëtare për të siguruar sigurinë e nevojshme dhe mbrojtjen e oficerit ndërlidhës, si dhe të anëtarëve të familjes së tij që përbëjnë pjesë të banorëve të shtëpisë, siguria e të cilëve rrezikohet nga kryerja e detyrave të oficerit ndërlidhës në Europol.

7. Lehtësirat dhe imunitetet përsa i përket komunikimit

1. Qeveria do të lejojë oficerin ndërlidhës të komunikojë lirisht dhe pa ndonjë nevojë për leje të veçantë, për të gjitha qëllimet zyrtare, dhe do të mbrojë të drejtën e oficerit ndërlidhës për të vepruar në këtë mënyrë. Oficeri ndërlidhës ka të drejtën për të përdorur kode dhe për të dërguar dhe marrë korrespondencë zyrtare dhe komunikime të tjera zyrtare me korrier ose në çanta të vulosura të cilat do të jenë subjektet të të njëjtave privilegje dhe imunitete si të korrierëve dhe çantave diplomatike.

2. Oficeri ndërlidhës për aq sa mund të jetë e pajtueshme me Konventën e Telekomunikacionit, datë 6 nëntor 1982, për komunikimet e tij zyrtare gëzon trajtim jo më pak të favorshëm se ai i akorduar nga Mbretëria e Holandës ndaj çdo organizate ndërkombëtare apo qeverie, në çështjen e prioriteteve për komunikim me postë, kabëll, telegraf, teleks, radio, televizion, telefon, faks, satelit ose mjete të tjera.

8. Informimi

1. Shteti dërgues do të njoftojë shpejt qeverinë për emrin e oficerit ndërlidhës, mbërritjen e tij dhe nisjen finale ose përfundimin e detyrës, si dhe mbërritjen dhe nisjen finale të anëtarëve të familjes së tij që përbëjnë pjesë të banorëve të shtëpisë dhe ku është e përshtatshme, faktin që një person ka pushuar së qeni pjesë e familjes.

2. Qeveria do t'i lëshojë oficerit ndërlidhës dhe anëtarëve të familjes së tij që përbëjnë pjesë të banorëve të shtëpisë, një kartë identifikimi me fotografinë e mbajtësit. Kjo kartë do të shërbejë për të identifikuar mbajtësin në marrëdhëniet me të gjitha autoritetet e shtetit pritës.

9. Zgjidhja e konflikteve

1. Çdo konflikt ndërmjet shtetit dërgues dhe qeverisë, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, ose ndonjë kërkesë që prek oficerin ndërlidhës ose marrëdhënien ndërmjet shtetit dërgues dhe qeverisë e cila nuk është zgjidhur miqësisht, do të referohet për vendimin përfundimtar para një trupi gjykues të përbërë nga tre arbitra, me kërkesë të shtetit dërgues ose qeverisë. Çdo palë do të caktojë një arbitër. Anëtari i tretë, i cili do të jetë kryetari i trupit gjykues, do të zgjidhet nga dy arbitrat e parë.

2. Nëse njëra nga palët dështon në caktimin e një arbitri brenda dy muajve pas një kërkesë të bërë nga pala tjetër për një caktim të tillë, pala tjetër mund t'i kërkojë Presidentit të Gjykatës së Drejtësisë të Komuniteteve Europiane ose në mungesë të tij zëvendëspresidentit, të bëjë një caktim të tillë.

3. Nëse dy arbitrat e parë dështojnë për të rënë dakord mbi arbitrin e tretë pas dy muajsh pasues nga emërimi i tyre, secila palë mund t'i kërkojë Presidentit të Gjykatës së Drejtësisë të Komuniteteve Europiane ose në mungesë të tij Zëvendëspresidentit, të bëjë një emërim të tillë.

4. Përveçse kur palët bien dakord ndryshe, trupi gjykues do t'i përcaktojë vetë procedurat e tij.

5. Trupi gjykues do të marrë vendime me shumicë votash. Kryetari do të ketë votë vendimtare. Vendimi do të jetë i formës së prerë dhe detyrues për palët në konflikt.

10. Shtrirja territoriale

Përsa i përket Mbretërisë së Holandës, kjo Marrëveshje do të zbatohet vetëm për pjesën e Mbretërisë në Europë.

Draftshënimi fillestar

Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës i paraqet komplimentet e saj Ambasadës së Republikës së Shqipërisë dhe ka nderin të propozojë, referuar Marrëveshjes Strategjike ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës Europiane të Policisë të 5 shkurtit 2007 (këtu e në vazhdim "Marrëveshja"), dhe duke pasur parasysh nenin 41, paragrafin 2 të Konventës bazuar në nenin K.3 të Traktatit të Bashkimit Europian, mbi krijimin e Zyrës Europiane të Policisë (Konventa e Europolit, 26 korrik 1995), që për privilegjet dhe imunitetet e nevojshme për përmbushjen e duhur të detyrave të oficerëve ndërlidhës në Europol referuar në nenin 12 të Marrëveshjes, të bihet dakord përsa është parashikuar në shtojcë.

Në qoftë se ky propozim është i pranueshëm për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës propozon që ky shënim dhe shënimi afirmues i ambasadës do të përbëjë një marrëveshje ndërmjet Mbretërisë së Holandës dhe Republikës së Shqipërisë, e cila do të aplikohet përkohësisht nga dita në të cilën ky shënim afirmues do të merret nga ministria, dhe i cili do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë që ndjek datën në të cilën Mbretëria e Holandës dhe Republika e Shqipërisë kanë informuar njëra-tjetrën që janë përmbushur formalitetet e kërkuara për hyrjen në fuqi.

Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës përfiton edhe njëherë nga rasti për t'i përsëritur Ambasadës së Republikës së Shqipërisë sigurimet e konsideratës së saj më të lartë.

LIGJ
Nr.10 263, datë 8.4.2010

**PËR PËRDORIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E TOKAVE BUJQËSORE TË
PAKULTIVUARA**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara, për të garantuar funksionin ekonomik të pronës, pa cenuar të drejtën e pronësisë, të përfutur sipas ligjit, në kuadrin e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor dhe rural.

Neni 2
Objekti

Objekt i këtij ligji janë:

- a) tokat bujqësore, në pronësi private, të zërit kadastral “arë”, që figurojnë si të tilla në regjistrat kadastralë shtetërorë, në seksionin e administrimit dhe mbrojtjes së tokës (më poshtë SAMT) në qark;
- b) tokat bujqësore, në pronësi private, të zërit kadastral “vreshta”, “pemëtore” dhe “ullishte”, që figurojnë si të tilla në regjistrat kadastralë shtetërorë, në SAMT, në qark, por që, nga verifikimet e kryera, sipas dispozitave vijuese të këtij ligji, nuk rezultojnë të kenë bimë hardhie, drurë frutorë dhe ullinj;
- c) tokat në përdorim, sipas përcaktimit të nenit 15 të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, të ndryshuar.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Tokë bujqësore” ka kuptimin e përcaktuar në pikën 3 të nenit 2 të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”;
- b) “Tokë bujqësore e zërit kadastral “arë”” është e gjithë sipërfaqja e tokës bujqësore, e destinuar për t’u mbjellë me bimë arash dhe që figuron si e tillë në regjistrat kadastralë shtetërorë;
- c) “Tokë bujqësore e zërit kadastral “vreshta”, “pemëtore” dhe “ullishte”” është e gjithë sipërfaqja e tokës bujqësore e mbjellë me hardhi, dru frutorë dhe ullinj dhe që figuron si e tillë në regjistrat kadastralë shtetërorë;
- ç) “Përdorim dhe shfrytëzim i tokës bujqësore” është veprimtaria, që ushtron për çdo vit pronari ose poseduesi i ligjshëm i tokës, për punimin, mbjelljen dhe kultivimin e bimëve bujqësore, në përputhje me praktikën e mira bujqësore, për marrjen e produkteve të dobishme prej tyre;

d) "Tokë bujqësore e pakultivuar" është toka bujqësore, e cila nuk është përdorur dhe shfrytëzuar për qëllime bujqësore, nëpërmjet mbledhjes dhe kultivimit të bimëve të arave, nga pronari ose poseduesi i ligjshëm, për të paktën 2 vjet radhazi.

KREU II EVIDENTIMI DHE PËRCAKTIMI I TOKAVE TË PAKULTIVUARA

Neni 4

Komisioni i evidentimit të tokave të pakultivuara

Për evidentimin e tokave bujqësore të pakultivuara, pranë çdo komune dhe/ose bashkie krijohet dhe funksion komisioni i evidentimit të tokave të pakultivuara me këtë përbërje:

a) përgjegjësi i zyrës së menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës (ZMMT) të komunës dhe/ose bashkisë kryetar;

b) përfaqësuesi i drejtorisë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit (DRBUMK) anëtar;

c) kryetari i fshatit përkatës anëtar.

Neni 5

Mënyra e evidentimit të tokave të pakultivuara

Komisioni bën çdo vit, brenda datës 15 shtator, verifikimin e sipërfaqeve të tokave të pakultivuara për çdo fshat. Verifikimi bëhet duke u bazuar në këqyrjen fizike të sipërfaqes së tokës, në të dhënat kadastrale dhe në informacionin e siguruar nga vetë pronari i saj. Në mungesë të pronarit, komisioni mund të sigurojë informacion nga pronarët kufitarë, të afërm të tij apo banorë të tjerë të fshatit.

Rezultatet e verifikimit, për çdo pronar ose posedues të ligjshëm, pasqyrohen në një dokument, forma dhe përmbajtja e të cilit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Dokumenti i verifikimit i paraqitet kryetarit të komunës dhe/ose bashkisë brenda datës 30 shtator të çdo viti.

Neni 6

Shpallja e listës së tokave të pakultivuara dhe paraqitja e ankesave

Kryetari i komunës dhe/ose bashkisë publikon, brenda datës 15 tetor të çdo viti, listën emërore të pronarëve ose poseduesve të ligjshëm me sipërfaqet përkatëse të tokave, të evidentuara si të pakultivuara në çdo fshat. Kjo listë afishohet për një afat prej 45 ditësh në qendër të komunës dhe në fshatin përkatës.

Për efekt të zbatimit të këtij ligji, afishimi i listës së mësipërme përbën njoftim zyrtar të çdo pronari ose poseduesi të ligjshëm.

Brenda kësaj periudhe, pronarët, emrat e të cilëve përfshihen në listë, kanë të drejtë të paraqesin ankesë, me shkrim, pranë kryetarit të komunës dhe/ose bashkisë, për saktësinë e evidentimit të kryer nga komisioni.

Kryetari i komunës dhe/ose bashkisë shqyrton ankesat e paraqitura, rast pas rasti, brenda 5 ditëve nga marrja e ankesës.

Neni 7

Vendimi për klasifikimin e tokave të pakultivuara

Kryetari i komunës dhe/ose bashkisë përgatit dokumentacionin e evidentimit të tokave të pakultivuara dhe ia paraqet këshillit të komunës dhe/ose bashkisë për shqyrtim dhe vendimmarrje, për klasifikimin e tyre si të tilla. Shqyrtimi bëhet brenda datës 15 janar të vitit pasardhës.

Këshilli i komunës dhe/ose bashkisë merr vendimet përkatëse për çdo fshat, të cilat përmbajnë identitetin e pronarit ose poseduesit të ligjshëm dhe sipërfaqen përkatëse të tokës, që klasifikohet e pakultivuar.

Vendimi i këshillit të komunës dhe/ose bashkisë është autorizim për kryetarin e komunës dhe/ose bashkisë për t'ua dhënë me qira këto toka subjekteve kërkuese.

Vendimi i këshillit të komunës dhe/ose bashkisë publikohet (shpallet) në vende të dukshme në qendër të komunës dhe/ose bashkisë, si dhe në qendër të çdo fshati. Kur është e mundshme, këto vendime publikohen edhe në median lokale.

KREU III

RIFILLIMI I KULTIVIMIT TË TOKËS NGA PRONARI OSE POSEDUESI I LIGJSHËM

Neni 8

Kërkesa e pronarit dhe poseduesit të ligjshëm për të kultivuar tokën

Pronari ose poseduesi i ligjshëm i sipërfaqeve të tokave të pakultivuara, të përfshira në vendim, mund t'i paraqesë një kërkesë me shkrim komunës dhe/ose bashkisë, brenda datës 31 janar, në të cilën merr përsipër detyrimin për të kultivuar këtë tokë, duke i bashkëlidhur kërkesës një plan për përdorimin e tokës, përfshirë kulturën bujqësore, sipërfaqen dhe afatet e kultivimit.

Neni 9

Miratimi i kërkesës

Kryetari i komunës dhe/ose bashkisë, brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës, ia përcjell për miratim këshillit të komunës dhe/ose bashkisë, i cili bën korrigjimin përkatës në listën e tokave të pakultivuara, për sipërfaqen e kërkuar për t'u mbjellë.

Neni 10

Pasojat e mosrealizimit të planit të përdorimit të tokës

Komisioni i evidentimit të tokave të pakultivuara ndjek realizimin e planit të përdorimit të tokës dhe informon kryetarin e komunës dhe/ose bashkisë.

Kur pronari ose poseduesi i ligjshëm i tokës nuk realizon planin e përdorimit të tokës brenda afateve të përcaktuara, toka konsiderohet e klasifikuar si e pakultivuar.

KREU IV

RREGULLAT PËR DHËNIEN ME QIRA TË TOKAVE BUJQËSORE TË PAKULTIVUARA

Neni 11

Dhënia me qira për mbjellje dhe afati

Tokat e klasifikuara si toka të pakultivuara, sipas përcaktimeve të neneve 7 dhe 10 të këtij ligji, u jepen me qira të tretëve, vetëm për kultivimin e bimëve të arave, për jo më shumë se 5 vjet.

Për tokat, objekt i shkronjës "c" të nenit 2 të këtij ligji, afati i qiradhënies është njëvjeçar, me të drejtë përsëritjeje.

Pronari ose poseduesi i ligjshëm i tokës nuk ka të drejtë të bëjë kërkesë për kultivimin e kësaj toke deri në përfundim të afatit të përcaktuar në kontratën përkatëse të qirasë.

Me mbarimin e kontratës së qirasë, komuna dhe/ose bashkia ka të drejtën e qiradhënies së kësaj toke, nëse pronari ose poseduesi i ligjshëm nuk ka ushtruar kërkesë për kultivimin e saj.

Neni 12

Autoriteti qiradhënës dhe procedurat

Komuna dhe/ose bashkia është autoriteti qiradhënës i tokave bujqësore të pakultivuara, të përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji.

Për dhënien me qira të këtyre tokave, pranë çdo komune dhe/ose bashkie krijohet bordi i qiradhënies (BQ), i cili kryesohet nga kryetari i komunës dhe/ose bashkisë dhe ka këta anëtarë:

- a) një përfaqësues të DRBUMK-së;
- b) një përfaqësues të SAMT-së në qark;
- c) përgjegjësin e zyrës së financës të komunës dhe/ose bashkisë ose një jurist;
- ç) përgjegjësin e ZMMT-së në komunë dhe/ose bashki.

Detyrat, përgjegjësitë e BQ-së, procedurat e dhënies me qira të tokave të pakultivuara dhe kontrata tip përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Subjektet qiramarrëse të tokave bujqësore të pakultivuara

Subjekte të qiramarrjes së tokave bujqësore të pakultivuara janë personat fizikë e juridikë, vendas dhe të huaj, që shprehin interes, me shkrim, për këtë veprimtari pranë komunës dhe/ose bashkisë përkatëse.

Shprehja e interesit përmban përshkrimin e veprimtarisë bujqësore që subjekti do të kryejë. Subjekti qiramarrës ka për detyrim ta përdorë tokën bujqësore në përputhje me praktikat e mira bujqësore dhe të shfrytëzimit të saj, sipas përcaktimeve të neneve 16, 17 dhe 18 të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”.

Neni 14

Mënyra e dhënies me qira të tokave bujqësore të pakultivuara

Mënyra e dhënies me qira të tokave bujqësore të pakultivuara bëhet me ankand. Në rastet kur paraqitet një kërkesë e vetme, nuk zhvillohet procedura e ankandit.

Neni 15

Çmimi minimal i dhënies së tokës me qira

Çmimi minimal, për dhënien me qira të tokës bujqësore të pakultivuar, të jetë 30 për qind më i ulët se vlera e qirasë vjetore të tokave bujqësore, të përcaktuar në pikën 2 të vendimit nr. 830, datë 28.12.1998, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e llogaritjes së vlerës vjetore të qirasë së tokave bujqësore, pyjore, me bimë pyjore, livadheve dhe kullotave, pasuri shtetërore”.

Neni 16

Pagesa e qirasë

Qiramarrësi paguan vlerën e qirasë për çdo vit pranë komunës dhe/ose bashkisë. Pagesa e parë bëhet me nënshkrimin e kontratës, pagesat e tjera bëhen pas çdo viti.

Neni 17

Përdorimi i të ardhurave të krijuara nga qiradhënia

Të ardhurat, që krijohen nga qiradhënia e tokave të pakultivuara, ndahen si më poshtë:

- a) 80 për qind, në dobi të pronarit apo poseduesit të ligjshëm të tokës, nga shuma e së cilës komuna dhe/ose bashkia mban vlerën e taksës vjetore mbi tokën;
- b) 20 për qind, në dobi të komunës dhe/ose bashkisë për mbulimin e shpenzimeve administrative, që lidhen me zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Neni 18

Njoftimi i pronarit ose poseduesit të ligjshëm

Pas lidhjes së kontratës ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit, komuna dhe/ose bashkia bën njoftimin zyrtar të pronarit ose poseduesit të ligjshëm të tokës bujqësore të pakultivuar.

Njoftimi përmban identitetin e qiramarrësit, llojin e veprimtarisë që ai do të kryejë, çmimin e qiradhënies dhe kohëzgjatjen e kësaj kontrate.

KREU V

INFORMIMI DHE MONITORIMI

Neni 19

Detyrimi për informim

Kryetari i komunës dhe/ose bashkisë dërgon pranë DRBUMK-së dhe këshillit të qarkut, brenda muajit janar, informacion me shkrim për vitin paraardhës, për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara. Forma dhe përmbajtja e informacionit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 20

Monitorimi

Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit monitoron procesin e përdorimit dhe shfrytëzimit të tokave të pakultivuara dhe, mbi bazën e informacioneve të marra e kontrolleve periodike të ushtruara nga strukturat vartëse, i propozon Këshillit të Ministrave dhe organeve të tjera përkatëse marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

KREU VI

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 21

Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet

1. Sipas këtij ligji, kur nuk përbëjnë veprë penale, janë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme:

a) mospjesëmarrja në veprimtaritë e komisionit të evidentimit të tokave të pakultivuara, sipas përcaktimit të nenit 4 të këtij ligji;

b) mospërmbushja e rregullt e detyrimeve të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji.

2. Kryetari i komunës dhe/ose bashkisë:

a) vendos gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) deri në 40 000 (dyzet mijë) lekë për kryetarin e fshatit, për kundërvajtje administrative, të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni;

b) i propozon kryetarit të këshillit të qarkut dhe drejtorit të DRBUMK-së vendosjen e gjobës nga 10 000 (dhjetë mijë) deri në 40 000 (dyzet mijë) lekë ndaj përfaqësuesve të këtyre institucioneve, në përbërje të komisionit të evidentimit të tokave të pakultivuara, për kundërvajtje administrative, të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni.

Kryetari i këshillit të qarkut dhe drejtori i DRBUMK-së miratojnë propozimin e kryetarit të komunës dhe/ose bashkisë për vendosjen e gjobës.

Neni 22
Ankimimi

Kundërvajtësi, brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit për vendosjen e gjobës, mund të bëjë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor.

Ekzekutimi i vendimeve kryhet sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.7697 datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, të ndryshuar.

KREU VII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 23
Fillimi i ushtrimit të kompetencave

Fillimi i ushtrimit të kompetencave, në vitin e parë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, është si më poshtë:

1. Për efekt të zbatimit të nenit 4 të këtij ligji, kryetari i komunës dhe/ose bashkisë krijon komisionin e evidentimit të tokave të pakultivuara brenda 2 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Për efekt të zbatimit të nenit 5 të këtij ligji, komisioni i evidentimit të tokave të pakultivuara kryen verifikimin e përdorimit dhe shfrytëzimit të tokës bujqësore nga pronarët dhe poseduesit e ligjshëm të saj për vitet 2008 dhe 2009. Verifikimi, evidentimi dhe dorëzimi i dokumentacionit të kryetari i komunës dhe/ose bashkisë bëhet brenda 2 muajve nga data e krijimit të komisionit.

3. Për efekt të zbatimit të nenit 6 të këtij ligji, kryetari i komunës dhe/ose bashkisë, brenda 15 ditëve nga dorëzimi i dokumentacionit nga komisioni, bën shpalljen e listës së pronarëve me sipërfaqet përkatëse të tokave të pakultivuara, me kohëzgjatje të afishimit prej 45 ditësh.

4. Për efekt të zbatimit të nenit 7 të këtij ligji, kryetari i komunës dhe/ose bashkisë, 5 ditë pas përfundimit të afatit të shpalljes, i paraqet për shqyrtim dhe vendimmarrje këshillit të komunës dhe/ose bashkisë dokumentacionin e evidentimit të tokave të pakultivuara, të shqyrtuar prej tij, përfshirë edhe ankesat e mundshme të pronarëve ose të poseduesve të ligjshëm.

5. Për efekt të zbatimit të nenit 7 të këtij ligji, këshilli i komunës dhe/ose bashkisë shqyrton dokumentacionin e paraqitur dhe merr vendime për klasifikimin e tokave bujqësore të pakultivuara brenda një muaji nga data e marrjes së tij. Vendimi i jepet për ekzekutim kryetarit të komunës dhe/ose bashkisë.

Neni 24
Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 12 të këtij ligji.

Ngarkohet Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit që, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5 dhe 19 të këtij ligji.

Neni 25
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6521, datë 28.4.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr. 10 264, datë 8.4.2010

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË LIGJIN NR. 7926, DATË 20.4.1995 “PËR
TRANSFORMIMIN E NDËRMARRJEVE SHTETËRORE NË SHOQËRI TREGTARE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 8, paragrafi i katërt ndryshohet si më poshtë:

“Anëtarët e këshillave mbikëqyrëse të shoqërive aksionare shtetërore i propozohen Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës si më poshtë:

- a) 1/3 e anëtarëve propozohet nga Ministri i Financave;
- b) 1/3 e anëtarëve caktohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës;
- c) 1/3 e numrit të anëtarëve propozohet nga ministria e linjës administrative apo nga organi i qeverisjes vendore, që përfaqëson shtetin për shoqërinë shtetërore përkatëse.

Mënyra e propozimit dhe e emërimit të anëtarëve të këshillave mbikëqyrëse të shoqërive aksionare të ujësjellës-kanalizimeve bëhet në përputhje me statutin e tyre.”.

Neni 2

Ngarkohen titullarët e ministrive që preken nga ky ligj që, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e tij, të bëjnë ndryshimet në këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6522, datë 28.4.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 265, datë 15.4.2010

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË LETONISË PËR BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT, KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKIMIT TË PALIGJSHËM TË DROGAVE, SUBSTANCAVE PSIKOTROPE DHE PREKURSORËVE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Letonisë për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6523, datë 28.4.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË LETONISË MBI BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT, KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKIMIT TË PALIGJSHËM TË DROGAVE, SUBSTANCAVE PSIKOTROPE DHE PREKURSORËVE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Letonisë (këtu referuar si “Palët”),

të udhëhequra nga përpjekjet për të kontribuar në forcimin e bashkëpunimit dypalësh,
të bindura në rëndësinë themelore të bashkëpunimit në luftën kundër krimit, veçanërisht terrorizmit, krimit të organizuar dhe trafikut të paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve,

duke pasur për qëllim rritjen e përpjekjeve të tyre të përbashkëta në luftën kundër terrorizmit,

duke dashur të harmonizojnë veprimet e tyre kundër krimit të organizuar ndërkombëtar;

duke marrë në konsideratë traktatet e rëndësishme ndërkombëtare,

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

1. Duke marrë në konsideratë legjislacionet kombëtare të palëve dhe në zbatim të përmbajtjes së kësaj Marrëveshjeje, palët do të bashkëpunojnë në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve.

2. Palët do të bashkëpunojnë kryesisht në rastet ku krimet ose përgatitjet e tyre janë bërë në një nga territoret shtetërore të palëve, dhe informacionet e marra i referohen territorit të shtetit të palës tjetër.

Neni 2

Në luftën kundër terrorizmit, palët:

1. Do të shkëmbejnë informacione, mbi aktet terroriste të kryera ose në planifikim e sipër, mbi pjesëmarrësit në këto akte kriminale, mbi metodat e kryerjes dhe pajisjet e përdorura.
2. Do të shkëmbejnë informacione, mbi grupet terroriste dhe pjesëtarët e këtyre grupeve, të cilat po përgatiten të kryejnë ose kanë kryer krime në një nga territoret shtetërore të palëve dhe që prekin interesat e palës tjetër, gjithashtu do të shkëmbehen informacione të cilat janë të nevojshme për të luftuar terrorizmin dhe krimet të cilat kërcënojnë seriozisht sigurinë publike.
3. Do të shkëmbejnë materiale analitike e të tjera që kanë lidhje me terrorizmin.
4. Do të shkëmbejnë eksperiencën dhe njohuritë në fushën e garantimit të sigurisë.
5. Në përputhje me legjislacionet kombëtare të palëve, me kërkesën e njëjës palë, pala tjetër ose të dyja palët së bashku do të kryejnë masa operacionale dhe të tjera.

Neni 3

Për të luftuar trafikun e paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve, palët:

1. Do të informojnë njëra-tjetrën, mbi personat të cilët janë të përfshirë në trafikimin e paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve, mbi vendet në të cilat fshihen, mjetet e transportit dhe metodat e kryerjes, mbi vendin e origjinës dhe destinacionin e drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve, si dhe çdo detaj tjetër të rëndësishëm që ka lidhje me këto krime, dhe që do të mund të ndihmojë në luftën kundër këtyre krimeve.
2. Do të informojnë njëra-tjetrën, mbi mënyrat e trafikimit të paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve, si dhe për fakte të tjera të rëndësishme.
3. Do të shkëmbejnë rezultatet e kërkimeve kriminalistike dhe kriminologjike mbi trafikun e paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve.
4. Do të vënë në dispozicion të njëra-tjetrës mostra të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve.
5. Do të shkëmbejnë eksperiencën në kontrollimin e tregtisë legale të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve.
6. Në përputhje me legjislacionin kombëtar të palëve, me kërkesën e njëjës prej palëve, do të kryejnë masa operacionale dhe të tjera.

Neni 4

Për të luftuar krimin, dhe kryesisht krimin e organizuar, palët:

1. Do të informojnë njëra-tjetrën, mbi personat e përfshirë në krimin e organizuar, lidhjet e tyre, strukturën e organizatave dhe grupeve kriminale, faktet e çështjeve (veçanërisht kohën, vendin dhe metodat e kryerjes), lehtësirat, masat e marra, dhe çdo detaj tjetër të rëndësishëm, që mund të jetë i nevojshëm për të luftuar krime të tilla.
2. Do të shkëmbejnë informacione për mënyrat e kryerjeve dhe format e reja të krimit të organizuar ndërkombëtar, si dhe për rastet e dyshuara për pastrim parash dhe financim terrorizmi.
3. Do të shkëmbejnë rezultatet e kërkimeve kriminalistike dhe kriminologjike eksperiencat mbi teknikat e hetimit dhe aplikimin e metodave të punës.
4. Në rast kërkesë, do të vënë në dispozicion të njëra-tjetrës informacione, si dhe mostra të objekteve, rezultat i akteve kriminale ose të përdorura për kryerjen e krimeve.

5. Do të shkëmbejnë ekspertë për trajnime të përbashkëta ose të ndërsjella, me qëllim rritjen e nivelit të ekspertizës dhe të studimit të arritjeve të reja në teknikat e investigimit, pajisjeve dhe metodave të përdorura në luftën kundër krimit.

6. Në përputhje me legjislacionin kombëtar të palëve, me kërkesë të njëjës palë, pala tjetër, ose së bashku, do të kryejnë masa operacionale dhe të tjera.

Neni 5

1. Me qëllim implementimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të palëve, nga ana e Republikës së Shqipërisë:

Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

Dhe nga ana e Republikës së Letonisë:

Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit, Policia Kufitare, Shërbimi i Buxhetit të Shtetit, brenda kompetencave dhe fuqive të veta, do të bashkëpunojnë direkt me njëri-tjetrin.

2. Autoritetet kompetente të palëve mund të specifikojnë fushat definitive të bashkëpunimit dhe format e komunikimit në protokolle të veçanta.

3. Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën me anë të kanaleve diplomatike me kontakte informative të autoriteteve kompetente dhe brenda juridiksionit të kompetencave të tyre të nevojshme për komunikimin reciprok.

4. Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën në kanale diplomatike për ndryshimet në listën e autoriteteve kompetente të palëve të cilat janë referuar në pikën 1 të këtij neni.

5. Në mungesë të një marrëveshjeje tjetër, gjuha angleze do të përdoret në komunikimin dhe shkëmbimin e informacioneve ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve.

Neni 6

1. Bashkëpunimi midis autoriteteve kompetente të palëve do të vazhdojë në bazë të kërkesës. Kërkesa do t'u paraqitet autoriteteve kompetente të palës tjetër brenda kompetencave të tyre.

2. Kërkesat për bashkëpunim do të bëhen zyrtarisht me shkrim dhe do të dorëzohen me anë të çdo mjeti të sigurt teknik. Kërkesat për bashkëpunim do të nënshkruhen nga kreu i autoritetit kompetent ose zëvendësi i tij, ose persona të tjerë të autorizuar dhe certifikuar me vulën e autoritetit kompetent.

3. Kërkesat për bashkëpunim do të mbajnë emrin e autoritetit kompetent kërkues, objektin e kërkesës, justifikimin ashtu si dhe informacione shtesë mbi të dhënat personale. Kërkesat për bashkëpunim mund gjithashtu të shoqërohen me dokumente shtesë që kanë të bëjnë me subjektin e kërkesës.

4. Nëse autoriteti kompetent i njëjës palë gjendet në pamundësi t'i përgjigjet ndonjë kërkesë, ai do t'i kalojë kërkesën një tjetri autoritet kompetent, të së njëjtës palë, duke njoftuar në të njëjtën kohë autoritetin kompetent kërkues.

Neni 7

Duke marrë në konsideratë legjislacionet kombëtare të palëve për mbrojtjen e të dhënave personale, të dhëna të cilat do të transmetohen përgjatë bashkëpunimit do të aplikohen kushtet e mëposhtme:

1. Pala marrëse mund t'i përdorë të dhënat vetëm për qëllimet dhe sipas kushteve të caktuara nga pala transmetuese.

2. Me kërkesë të palës transmetuese, pala marrëse jep informacione mbi përdorimin e të dhënave të transmetuara dhe rezultatet e arritura.

3. Të dhënat personale mund të përdoren vetëm nga autoritetet kompetente të palëve, referuar në paragrafin 1 të nenit 5 të Marrëveshjes, në luftën kundër terrorizmit, krimit të

organizuar, trafikut të paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve. Të dhënat mund t'i vihen në dispozicion një autoriteti tjetër vetëm më pas një leje paraprake me shkrim nga pala transmetuese.

4. Pala transmetuese merr përsipër të sigurojë që të dhënat e transmetuara të jenë korrekte dhe verifikon nëse transmetimi i të dhënave është i nevojshëm dhe korrespondon me qëllimin e menduar. Në rast se vërtetohet se të dhënat e dërguara rezultojnë jokorrekte ose të paautorizuara, pala marrëse duhet të informohet menjëherë. Pala marrëse korrekton gabimet ose, në rast se të dhënat nuk duhet të ishin transmetuar, i asgjëson.

5. Personit, të dhënat personale të të cilit janë dërguar, me kërkesë të tij dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar të palëve kontraktuese, duhet t'i jepet informacioni i nevojshëm mbi të dhënat dhe mbi synimin e përdorimit të tyre; në interes të sigurisë kombëtare dhe të rendit publik, këto informacione mund të refuzohen.

6. Në momentin e transmetimit të të dhënave, pala dërguese informon palën marrëse mbi afatin përfundimtar për asgjësimin e tyre, në përputhje me legjislacionin kombëtar të palës dërguese. Pavarësisht afatit të dhënat që lidhen me këtë person duhet të fshihen sapo të mos jenë më të nevojshme. Pala dërguese duhet të informohet mbi fshirjen e të dhënave të transmetuara, dhe mbi arsyet e fshirjes së tyre. Me përfundimin e kësaj Marrëveshjeje të gjitha të dhënat e marra si rrjedhojë e saj, duhet të asgjësohen.

7. Palët mbajnë regjistër të të dhënave të transmetuara, të dhënat e marra dhe të shuara në database, i cili të jetë i ndërtuar veçanërisht për këtë qëllim.

8. Palët mbrojnë në mënyrë efektive të dhënat personale të transmetuara, kundër akseseve të paautorizuara, ndryshimeve dhe publikimeve.

Neni 8

1. Palët mbrojnë fshehtësinë e informacionit të klasifikuar të tillë, në përputhje me legjislacionet kombëtare të palëve dhe kur kërkohet në bazë të legjislacionit kombëtar të palës dërguese.

2. Dokumentet, të dhënat dhe pajisjet teknike të transmetuara, si rrjedhojë e kësaj Marrëveshjeje, mund t'i kalojnë një shteti jopalë e kësaj Marrëveshjeje, vetëm pasi të jetë marrë leje me shkrim nga pala dërguese.

Neni 9

1. Me qëllim promovimin dhe forcimin e bashkëpunimit si rrjedhojë e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të palëve mund të ngrënë një komision të përbashkët. Palët njoftojnë njëra-tjerën mbi anëtarët e caktuar për komisionin e përbashkët me anë të kanaleve diplomatike.

2. Komisioni i përbashkët mban takime me iniciativë të secilës palë. Komisioni i përbashkët mban takime me radhë në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Letonisë.

Neni 10

Secila prej palëve mund ta refuzojë ose ta kushtëzojë, në tërësi ose pjesërisht, kërkesën për ndihmë ose për bashkëpunim, në rastet kur kryerja e saj kërcënon pavarësinë, rrezikon sigurinë, rendin publik, interesa të tjera baze ose dhunon legjislacionin e saj kombëtar.

Neni 11

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk cenojnë zbatimin e dispozitave të traktateve të tjera dypalëshe apo shumëpalëshe të lidhura nga Republika e Shqipërisë ose Republika e Letonisë.

Neni 12

Autoritetet kompetente të secilës palë mbartin shpenzimet e zakonshme të bëra prej tyre duke iu përshtatur kërkesës, por për pagesat e shpenzimeve të paparashikuara do të bihet dakord veçmas nga autoritetet kompetente të palëve në fjalë.

Neni 13

1. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me rrugën e negociatave direkte ose konsultimeve ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve brenda kompetencave të tyre.

2. Në rast se nuk bihet dakord me mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, referuar në pikën 1 të këtij neni, mosmarrëveshjet do të zgjidhen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 14

Palët mund të bëjnë ndryshime dhe shtesa mbi këtë Marrëveshje në formën e protokolleve, të cilat bëhen pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje. Ndryshimet dhe shtesat e kësaj Marrëveshjeje hyjnë në fuqi në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të nenit 15 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 15

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë kohe të pacaktuar dhe hyn në fuqi në ditën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, ku palët njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme, të nevojshme për hyrjen në fuqi.

2. Secila palë mund ta përfundojë në çdo kohë këtë Marrëveshje, me anë të një kërkesë me shkrim për këtë qëllim drejtuar palës tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Kjo Marrëveshje humb çdo lloj efekti pas 90 ditëve nga marrja e njoftimit.

Bërë në Tiranë, më 16 dhjetor 2009 në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe, letone dhe angleze, të gjitha tekstat të barasvlershme. Në rast se do të ketë keqkuptime në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë epërsi.

LIGJ

Nr.10 266, datë 15.4.2010

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8897, DATË 16.5.2002 “PËR MBROJTJEN E AJRIT NGA NDOTJA”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr.8897, datë 16.5.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 1 Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të garantojë të drejtën e çdo individi për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, të mbrojtë shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit shqiptar nga ndotja e ajrit nëpërmjet:

a) parashikimit të masave për cilësinë e ajrit të mjedisit, me qëllim shmangien, parandalimin ose uljen e pasojave të dëmshme mbi shëndetin dhe mjedisin në tërësi;

b) vlerësimit të cilësisë së ajrit të mjedisit në bazë të metodave e të kriterëve që përdoren në komunitetin europian;

c) marrjes së informacionit të përshtatshëm për cilësinë e ajrit të mjedisit dhe për të siguruar disponueshmërinë e këtij informacioni për publikun, midis të tjerave, edhe me anë të pragjeve sinjalizuese;

ç) ruajtjes së cilësisë së ajrit të mjedisit, kur ajo është e mirë, dhe përmirësimit të tij në raste të tjera.”.

Neni 2

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 2 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ajër i mjedisit” është ajri i jashtëm, i troposferës, që nuk përfshin ajrin në vendet e punës.

2. “Ndotës” është çdo substancë e futur nga njeriu në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë tek ajri i mjedisit dhe që mund të ketë efekte dëmtuese në shëndetin e njeriut dhe/ose në mjedisin në tërësi.

3. “Gazi radon” është gaz inert radioaktiv, pa ngjyrë, pa erë dhe pa shije, i cili formohet nga zbërthimi natyror i uraniumit në tokë, shkëmb dhe ujë.

4. “Cilësia e ajrit të brendshëm” është cilësia e ajrit dhe mjedisit brenda dhe përreth banesave e ndërtesave, me ndikim në shëndetin dhe mirëqenien e individëve.

5. “Nivel” është përqendrimi i një ndotësi në ajrin e mjedisit ose depozitimi i tij mbi një sipërfaqe në një kohë të caktuar.

6. “Vlerësim” është çdo metodë e përdorur për matjen, llogaritjen, parashikimin ose vlerësimin e nivelit të një ndotësi në ajrin e mjedisit.

7. “Vlerë kufi” është një nivel i cilësisë së ajrit, i caktuar në bazë të dijeve shkencore, me synim shmangien, parandalimin ose pakësimin e efekteve të dëmshme mbi shëndetin e njeriut dhe/ose mbi mjedisin në tërësi, që arrihet brenda një periudhe të caktuar dhe nuk duhet shkelur kur është arritur.

8. “Vlerë e synuar” është niveli i caktuar i cilësisë së ajrit, me synim shmangien e efekteve më afatgjata të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe/ose mbi mjedisin si një tërësi, që arrihet, kur është e mundur, në një periudhë të caktuar.

9. “Prag sinjalizues” është niveli, përtej të cilit ekziston rreziku ndaj shëndetit të njeriut nga ekspozimi i shkurtër dhe për të cilin duhet të merren masa të menjëhershme, të parashikuara në këtë ligj.

10. “Kufiri i tolerancës” është përqindja e vlerës kufi, me të cilën kjo vlerë mund të tejkalohet, duke iu nënshtruar kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

11. “Grumbullim” është zona e monitorimit të cilësisë së ajrit, me popullsi mbi 250 000 banorë, ose atje ku përqendrimi i popullsisë është më pak se 250 000 banorë, por me një dendësi për km², që e justifikon nevojën për vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit.

12. “Tregues mjedisor” është treguesi që jep të dhëna për një dukuri mjedisore, duke e bërë atë të perceptueshme, nëpërmjet vlerës numerike, matjes dhe komunikimit, nga ku:

a) “treguesi mjedisor i gjendjes së ajrit” është treguesi që jep të dhëna për cilësinë e ajrit;

b) “treguesi mjedisor i trysnisë në ajër” është treguesi që jep të dhëna për trysnitë që ushtrojnë në ajër burimet e ndotjes.

13. “Gjendje smogu” është ndotja e tejskajshme e atmosferës, kur niveli i ndotjes tejkalon ndjeshëm normat e cilësisë së ajrit.

14. “Monitorim” është procesi që realizon vlerësimin sistematik të treguesve mjedisorë.

15. “Burim ekzistues i ndotjes” është veprimtaria që ka filluar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

16. “Burim i ri ndotjeje” është veprimtaria që fillon të ushtrohet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

17. “Normë e cilësisë së ajrit” është vlera më e madhe e lejueshme e një treguesi mjedisor të gjendjes së ajrit dhe që shprehet me sasinë në peshë të një ndotësi në njësinë e vëllimit të ajrit.

18. “Normë e depozitimit” është vlera më e madhe e lejueshme e një treguesi mjedisor të gjendjes së ajrit, që ushtron ndikim në mjedisin pritës e që shprehet si sasia në peshë e tij në njësinë e sipërfaqes dhe për një kohë të dhënë.

19. “Normë e shkarkimeve në ajër” është sasia më e madhe e lejuar e ndotësit, që shkarkohet në ajër nga një burim ndotjeje, i cili nuk tejkalon nivelin e lejuar të treguesve mjedisorë të trysnisë, si dhe të shkallës së lejueshme të errësimit të tymit. Ajo shprehet si përqendrim në peshë ose në vëllim i ndotësit në gazin mbetës.

20. “Burim i lëvizshëm” quhet objekti që i shkarkon lëndët ndotëse, duke qenë në lëvizje.

21. “Operator i burimit të ndotjes” është çdo person fizik ose juridik, pronar i një burimi ndotjeje.

22. “Autoriteti i mbrojtjes së ajrit” është Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe organet e tjera të ngarkuara nga ky ligj e nga akte të tjera normative, për mbrojtjen e pastërtisë së ajrit.

23. “Ministria” është Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

24. “Ministër” është ministri që drejton Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.”.

Neni 3

Neni 4 i Kreut II ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4

1. Treguesit mjedisorë bazë të gjendjes së ajrit shprehin përmbajtjen e ndotësve të mëposhtëm atmosferikë:

a) dioksidit të sulfurit;

b) dioksidit të azotit;

c) lëndëve të imëta grimcore, si bloza (përfshirë PM 10);

ç) lëndëve grimcore në gjendje pezull;

d) plumbit (aerosol);

dh) ozonit.

2. Ndotës të tjerë të ajrit janë edhe:

a) benzene;

- b) monoksidi i karbonit;
 - c) hidrokarburet poliaromatike;
 - ç) kadmiumi;
 - d) arseniku;
 - dh) nikeli;
 - e) mërkuri.
3. Ndotës i ajrit të brendshëm:
- a) gazi radon.”.

Neni 4

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 5

1. Për zona të veçanta, në varësi të natyrës së shkarkimeve në ajër dhe sipas nevojës, Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Shëndetësisë, miraton vlerat kufi, pragun sinjalizues, kufirin e tolerancës dhe vlerat e synuara të cilësisë së ajrit për ndotësit e listuar në nenin 4 të ligjit, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Shëndetësisë miraton me vendime të veçanta normat e depozitimit, si dhe normat e shkarkimeve në ajër për zona specifike.”.

Neni 5

Pas nenit 5 shtohet Kreu II/1 me këtë përmbajtje:

“KREU II/1 MENAXHIMI I CILËSISË SË AJRIT

Neni 5/1

Plani i monitorimit dhe i menaxhimit të cilësisë së ajrit

1. Për monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit hartohet një plan, në të cilin territori i Republikës së Shqipërisë ndahet sipas zonave të veçanta të monitorimit të cilësisë së ajrit.

2. Plani përcakton zonat e monitorimit të cilësisë së ajrit, të cilat do të klasifikohen si “grumbullime”, në rast se:

- a) në to ka një përqendrim popullsie më të lartë se 250 000 banorë;
- b) në to ka një përqendrim popullsie më pak se 250 000 banorë, por me dendësi për km², që justifikon nevojën për një rivlerësim dhe menaxhim të cilësisë së ajrit të mjedisit;
- c) bazuar në të dhënat studimore, burimi apo burimet ndotëse dhe dendësia e lartë e popullsisë për km² justifikojnë nevojën e vlerësimit të cilësisë së ajrit.

3. Plani i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave e të Ministrit të Shëndetësisë.

Neni 5/2

Monitorimi i cilësisë së ajrit

1. Ministria bën një vlerësim paraprak të cilësisë së ajrit, në bazë të matjeve, analizave, mbikëqyrjes dhe rivlerësimeve për çdo zonë monitorimi.

2. Monitorimi i cilësisë së ajrit të mjedisit, për çdo zonë monitorimi, i referohet vlerës kufi të cilësisë së ajrit, pragut sinjalizues dhe vlerës së synuar të cilësisë së ajrit.

3. Ministri, në bazë të vlerave kufi për cilësinë e ajrit e kufirit të tolerancës, miraton udhëzimin “Për vlerësimin e cilësisë së ajrit”, në të cilin përcaktohen:

- a) metoda dhe analiza e vlerësimit të cilësisë së ajrit;
- b) aparatet matëse që do të përdoren;
- c) saktësia e matjes nga aparatet matëse;
- ç) mënyra e mbajtjes në kontroll të cilësisë dhe të saktësisë së funksionimit të aparateve vlerësuese, kryesisht me anë të kontrolleve të brendshme të cilësisë, të kryera në përputhje me kërkesat e standardeve europiane të sigurimit të cilësisë;
- d) kërkesa të hollësishme për raportimin dhe menaxhimin e të dhënave;
- dh) zbatimi i kompetencave dhe përgjegjësi të ministrisë e të agjencive të specializuara, lidhur me monitorimin e cilësisë së ajrit.

Neni 5/3

Menaxhimi i cilësisë së ajrit

1. Për zonat e monitorimit të cilësisë së ajrit, në të cilat nivelet e ndotjes së ajrit janë sipër vlerave kufi të cilësisë së ajrit dhe/ose vlerave të synuara të cilësisë së ajrit, ministria dhe organi përkatës i qeverisjes vendore marrin masa për informimin e publikut, për menaxhimin e këtyre niveleve, duke i mbajtur ato nën vlerën kufi dhe/ose në vlerën e synuar të cilësisë së ajrit.

2. Nëse nga monitorimi i cilësisë së ajrit brenda zonës së monitorimit konstatohet se vlerat kufi dhe/ose vlera kufi e synuar e cilësisë së ajrit dhe ndonjë kufi tjetër tolerance i zbatueshëm nuk arrihen, ose ka shumë mundësi që kjo të ndodhë, ministri e cakton këtë zonë si zonë veprimi për cilësinë e ajrit, duke marrë dhe masat përkatëse për menaxhimin e cilësisë së ajrit.

Neni 5/4

Plani Kombëtar i Veprimit për Cilësinë e Ajrit

1. Për parandalimin dhe/ose pakësimin e ndotjes së cilësisë së ajrit hartohet Plani Kombëtar i Veprimit për Cilësinë e Ajrit me afat 5-vjeçar, i cili rishikohet dhe përditësohet herë pas here, nëse është e nevojshme.

2. Ky plan përmban:

- a) një analizë të gjendjes aktuale;
- b) një analizë të përmbajtjes së planeve ose të programeve të sektorëve të tjerë, që mund të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo në nivelet e cilësisë së ajrit;
- c) ndërhyrje konkrete dhe me kosto efektive për parandalimin dhe/ose pakësimin e ndotjes së ajrit;
- ç) rekomandime për kërkime dhe/ose për veprimtari monitorimi të mëtejshme.

3. Plani Kombëtar i Veprimit për Cilësinë e Ajrit, përpara se të miratohet, diskutohet, paraprakisht, me publikun e pas miratimit bëhet publik.

4. Plani Kombëtar i Veprimit për Cilësinë e Ajrit miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e përbashkët të Ministrisë të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrisë të Shëndetësisë, jo më vonë se brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 5/5

Planet vendore të veprimit për cilësinë e ajrit

1. Brenda 60 ditëve nga data e caktimit të një zone veprimi për cilësinë e ajrit, organi i qeverisjes vendore, që administron këtë zonë veprimi, harton planin vendor të veprimit për cilësinë e ajrit.

2. Plani vendor i veprimit për cilësinë e ajrit është në përputhje e në zbatim të Planit Kombëtar të Veprimit për Cilësinë e Ajrit dhe përmban:

a) një analizë për problemet ekzistuese të cilësisë së ajrit brenda një zone veprimi, përfshirë dhe ndikimin në cilësinë e ajrit të praktikave e të planeve të përdorimit të tokës dhe të planeve vendore të transportit dhe ndikimin e masave të parashikuara në Planin Kombëtar të Veprimit për Cilësinë e Ajrit dhe në këtë ligj;

b) parashikime të tjera për:

i) hartimin e një programi, ku të përcaktohet marrja e masave të hollësishme për riorganizimin e problemeve të konstatuara, përfshirë propozime për ndryshime, nëse është e nevojshme, të planeve ekzistuese të përdorimit të tokave dhe të planeve të transportit;

ii) hartimin e një programi për zgjidhjen e problemeve të cilësisë së ajrit dhe të ruajtjes ose të arritjes së vlerës kufi të cilësisë së ajrit dhe/ose vlerës së normës, brenda një afati kohor të caktuar;

iii) hartimin e një plani vendor transporti, nëse nuk ka, në bashkëpunim me strukturat vendore përgjegjëse për transportin, për të gjithë ose për një pjesë të territorit të përfshirë në zonë.

Planet vendore të veprimit për cilësinë e ajrit rishikohen dhe përditësohen çdo 2 vjet.

3. Organet e qeverisjes vendore, në hartimin e planit vendor të veprimit për cilësinë e ajrit sigurojnë pjesëmarrjen e publikut dhe, pas miratimit të tij, e bëjnë atë publik. Plani vendor i veprimit miratohet nga këshilli bashkiak i qeverisjes përkatëse vendore dhe është i detyrueshëm për zbatim nga të gjitha organet përkatëse të qeverisjes vendore.

4. Rregullat për hartimin e planeve vendore të veprimit për cilësinë e ajrit miratohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, të Ministrit të Shëndetësisë dhe të ministrit përgjegjës për organet e qeverisjes vendore.

Neni 5/6

Komiteti i Veprimit për Cilësinë e Ajrit

1. Nëse zona e veprimit për cilësinë e ajrit përfshihet në administrimin e më shumë se një bashkie ose komune, ngrihet një Komitet Veprimi për Cilësinë e Ajrit, me përfaqësues nga organet përkatëse të qeverisjes vendore.

2. Komiteti bashkërendon punën për hartimin, miratimin dhe zbatimin e planit vendor të veprimit për cilësinë e ajrit.

3. Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministri i Shëndetësisë dhe ministri përgjegjës për organet e qeverisjes vendore miratojnë rregulloren për detyrat dhe funksionimin e Komitetit të Veprimit për Cilësinë e Ajrit.

Neni 5/7

Zbatueshmëria e planeve vendore të veprimit për cilësinë e ajrit

Organi i qeverisjes përkatëse vendore, për zbatimin e planit vendor të veprimit për cilësinë e ajrit, nxjerr akte normative, me anë të të cilave mund, por pa u kufizuar:

a) të rishikojë kërkesat e shkarkimeve në ajër, që përmban leja mjedisore e lëshuar prej tij ose ta pezullojë atë;

b) të pezullojë ose të kufizojë shkarkimet në ajër nga çdo burim tjetër;

c) të mbyllë përkohësisht ose përgjithmonë rrugët e qarkullimit të automjeteve, të përfshira në zonën e veprimit për cilësinë e ajrit;

ç) të vendosë kufizime për përdorimin e rrugëve nga automjetet me motor, duke mos përfshirë kufizimin e përdorimit të këtyre rrugëve për transportin publik dhe të banorëve;

d) të parashikojë kufizimin e parkimit dhe/ose të ngarkimit;

dh) të parashikojë, për automjetet me motor, vendet e shkarkimeve e të qëndrimeve, gjatë përdorimit të rrugëve, në zonat në ndërtim;

e) të rregullojë më mirë trafikun, për të pakësuar ose për të parandaluar bllokimin;

- ë) të ndalojë përdorimin e mjeteve me motor me djegie të brendshme në zonat në ndërtim;
- f) të përcaktojë kërkesa specifike, të detyrueshme për t'u respektuar, gjatë veprimtarive ndërtuese dhe në kantieret e ndërtimit.”.

Neni 6
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të neneve 4, 5/1 pika 3 e 5/4 pika 4.
2. Ngarkohen ministrat përkatës që, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 5/5 pika 4 e 5/6 pika 3.
3. Ngarkohen organet përkatëse të qeverisjes vendore të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të nenit 5/7 të këtij ligji.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6524, datë 28.4.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 30.4.2010

Doli nga shtypi më 3.5.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 24 lekë